



Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

PROCESVERBAL

Mbledhja e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale është mbajtur me datë **25.11.2022 (e premte)** me fillim në ora **08:30**. Mbledhjen e tretë e kryesoi kryesuesja znj. **Vlora Vuçiterna Çmega**.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Të ndryshme;
3. Vizitë në Qendrën Për Punë dhe Përkujdesje Sociale në Rahovec (QPS);

Kryesuesja – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ky është rendi i ditës për sot, pa humbur kohë fillojmë me pikën e parë.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja – A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Unanimisht kalon kjo pikë.

2. Të ndryshme;

Kryesuesja – Dikush nga anëtarët ndonjë gjë rreth pikës së dytë?... Atëherë vazhdojmë me pikën e fundit.

3. Vizitë në Qendrën Për Punë dhe Përkujdesje Sociale në Rahovec (QPS);

Lirigzon Kastrati – Përshëndetje për anëtarët e komitetit, për sekretarinë e kuvendit. Në muajin dhjetor i bie që e kemi edhe një mbledhje të fundit për këtë vit kalendarik. Kërkoj që të diskutojmë rreth planit të veprimit dhe raportit informues.

Kryesuesja – Faleminderit Lirigzon. Atëherë rreth pikës së tretë drejtori është i njoftuar me kohë, mesiguri është duke na pritur. Po e përmbyllim takimin për sot duke vazhduar vizitën. Faleminderit.

Mbledhja ka përfunduar në ora 08:50

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

